# Blerim Tominaj

PROKUROR NË PROKURORINË E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

**Deklaratat e analizuara:**

**15 Deklarata të analizuara**

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2017)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017




Pasuria bruto është rritur 28.2 herë nga fillimi I detyrës deri me datë 31.12.2017.

+ 3,499,332 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë

## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë

Likuiditete në Bankë




Likuiditete në Cash




Pasuritë e Luajtshme




Pasuritë e Paluajtshme




## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

| Të Ardhurat 2004-2017 | Shuma në Lekë | Raporti në % |
|---|---|---|
| Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga funksioni | 17,532,393 | 70.03% |
| Të ardhura nga paga e familjarëve | 5,573,552 | 22.26% |
| Të ardhura nga qeradhënia | 1,928,000 | 7.70% |
| Total | 25,033,945 | 100% |

## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

**3 Me Probleme**
**11 Pa Probleme**

Subjekti Blerim Tominaj rezulton me pasuri te pajustifikuar në 3 vite të deklarimit të pasurisë, në vitin 2011, 2012 dhe 2013 në një total prej 3,656,742 lekë (në këtë analizë nuk janë përfshirë shpenzimet e konsumit familjar).
Në vitin 2010, subjekti deklaron huamarrje në vlerë 100,000 euro për blerje apartamenti- por nuk ka asnjë të dhënë nëse është prenotuar apo blerë apartament këtë vit. Ndërkohë në vitin 2011 deklarohet blerje lokali me sipërfaqe 75m2 me vlerë 140,000 euro, që mendohet të jetë financuar me huanë e një viti më parë dhe një hua tjetër prej 8,000 euro marrë pa kontratë, pa afat dhe pa interes.
Nga totali i shumës së marrë hua  prej 108,000 eurosh, janë shlyer ndër vite 61,000 euro dhe diferenca prej 47,000 euro vazhdon të jetë detyrim i pashlyer deri me datë 31.12.2017.
Në deklarimin e vitit 2016, prokurori Tominaj ka deklaruar dy pasuri të paluajtshme: (1)apartament në Durrës me vlerë 26,500 euro, dhe (2)Lokal  në rr.Durrësit, kontratë sipërmarrje me firmën LIM-EM me vlerë 170,050 euro; përfituar me vendim për lëshim dëshmi trashëgimie dt. 05.03.2016.